



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 3202 /2019

Data: 08.04.2019

PROCESVERBALI  
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e tretë -III- për vitin 2019 e Komitetit për Politik dhe Financa, mbajtur me datë 19.03.2019 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkryetar i Komunës), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport), Sevime Laçi (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik), Edon Curri (Drejtor për Administratë), Përfaqësuesi i OSB-së, Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore), Irfan Suma (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Betime Bushi (Praktikante në Komunë). Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politik dhe Financa.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i nismës për bashkëpunim ndër komunal ndërmjet komunës së Hanit të Elezit dhe komunës së Çelanos (Itali).
3. Shqyrtimi i planit komunal të veprimit për efikasitetin e energjisë për vitin 2019-2021.
4. Shqyrtimi i raportit të punës së komitetit për komunitete për vitin 2018.
5. Shqyrtimi i raportit të punës së tri komiteteve konsultative për vitin 2018.
6. Njoftim për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2018.
7. Njoftim për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2018.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutim.

Akif Shkreta thekson:- pajtohem me rendin e punës por vërejtje kam te mos pjesëmarrja e ekzekutivit në mbledhje nuk është në rregull po ma rikujton fundin e mandatit. Drejtorët e drejtorive komunale a janë me leje apo çka është problemi?

Mehmet Ballazhi thekson:- është çështje e tyre pse nuk vijnë por Kryetari i Komunës patë potencuar një herë në pyetjen që ja parashtrua se pse nuk vijnë nëpër debate apo dëgjime publike dhe u përgjigj që qytetarët nuk po kanë nevojë me ardhur sepse po e dinë që i kryejmë krejt. Ndoshta ne mund të kemi sepse në rend dite është edhe pika të ndryshme.

Mallzum Qajani thekson:- përveç drejtorit për shërbime publike dhe emergjencë drejtorët e tjerë nuk kanë ndonjë çështje që duhet të diskutohet sepse nuk kanë pika në rend të punës. Ju mund të parashtroni pyetje dhe në mbledhje të ardhshme mund të përgjigjen drejtorët.

Akif Shkreta thekson:- duhet të shikohet kjo se a është e precizuar që drejtorët me marr pjesë në mbledhje.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- çështja e pjesëmarrjes së drejtorëve duhet të diskutohet dhe të definohet kjo çështje.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për rendin e punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

#### MIRATOHET RENDI I PUNËS

##### 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutim, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

#### MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

##### 2. Shqyrtimi i nismës për bashkëpunim ndër komunal ndërmjet komunës së Hanit të Elezit dhe komunës së Çelanos (Itali).

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- ne dimë që qytetarët e Hanit të Elezit ja kanë parë hajrin shumë komunës së Çelanos sepse një pjesë e qytetarëve tonë në vitet e nëntëdhjeta kanë punuar atje dhe një pjesë e të mirave i kanë nga ky vend. Në bisedë me qytetarët tanë të cilët kanë punuar atje kanë shumë fjalë të mira për arsye se në kohën kur na kemi pasur krizën më të madhe nuk ju ka bërë pengesë askush atje qytetarëve të Hanit të Elezit për me punuar. Kjo kërkesë për binjakëzim në mes të komunës së Hanit të Elezit dhe komunës së Çelanos është më konkrete sepse kryetari ka qenë në vizitë atje dhe udhëheqja e komunës së Çelanos ka shprehur gatishmëri dhe ne kemi shprehur gatishmëri me lidh marrëveshje dhe po duamë që na ta funksionalizojm dhe të bëhet e plot fuqishme.

**Nora Xhoni** thekson:- i gëzohem këtij bashkëpunimi sidomos për rininë dhe sportin por ndoshta liberalizimi i vizave do ta pengon këtë çështje.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- në mbledhjen e fundit të kuvendit të komunës e mbështeta realizimin e vizitës së Kryetarit të Komunës në Çelano të Italisë dhe më erdh jashtëzakonisht mirë. Por nuk më ka ardhur mirë se përse ka zgjatur kaq kohë. Në Çelano isha në vizitë dhe në atë kohë kanë qenë një numër mbi njëqind e më shumë qytetarë të cilët kanë pas një klub për organizimin e aktiviteteve të ndryshme dhe më vonë është shpërndarë ai klub dhe kanë shkuar në Gjermani, Austri dhe vende të tjera për shkak se nuk ka pasur kujdes të brendshëm siç ishte para një kohe. Do të ishte mirë që me specifikuar bashkëpunimin sepse nuk është problem çështja e vizave për shkak se kur ka bashkëpunim vizat mund të rregullohen më lehtë. Duhet të identifikohen kërkesat e qytetarëve të komunës së Hanit të Elezit se cilat janë dhe me i renditur me pika me të cilat do të ishim fokusuar me komunën e Çelanos. Përveç identifikimit të kërkesave duhet të caktohet edhe grupi punues për me i bashkërenditur kërkesat e qytetarëve këtu me mundësitë e atyre që janë atje sepse fusha e arsimit është shumë e gjerë, zhvillimi ekonomik është shumë i gjerë. Drejtori i shërbimeve publike do të ishte shumë e domosdoshme me marr pjesë në atë takim që ishte Kryetari i Komunës sepse shërbimet publike janë një ndër pikat më të rëndësishme në komunën e Hanit të Elezit.

**Akif Shkreta** thekson:- është një nismë që duhet të mbështetet nga të gjithë. Do të ishte mirë që të hartohet një plan për secilën fushë dhe me u identifikuar se çka mendojmë ne për me përfutur ne nga komuna e Çelanos.

**Mallzum Qajani** thekson:- ne po flasim se çka kemi me bërë dhe jemi në hapin e parë dhe hapi i parë është zyrtarizimi i binjakëzimit. Zyrtarizimi është iniciativë e kuvendit të komunës dhe vendimi që do të merret në kuvendin e komunës dhe duhet të dërgohet në Ministri të Administrimit të Pushtetit Lokal. Vendim duhet të merr edhe komuna e Çelanos dhe dy komunat marrin vendim për binjakëzim dhe bëhet plani për bashkëpunim pasi të kryhen procedurat zyrtare.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- është e qartë se duhet të zyrtarizohet kjo por me gjithë atë është një plan paraprak sepse pa i pasur qëllimet se duhet me u binjakëzuar me një komunë i bien që të binjakëzohemi dhe pastaj shohim se në cilat pika. Do të ishte mirë që të identifikohen se në cilat fusha kemi nevojë më shumë dhe i përcaktojmë sepse më lehtë do ta kemi edhe në kuvend për me arsyetuar për çështjet kryesore që kemi me i diskutuar.

**Bajrush Laçi** thekson:- kur të bëhet marrëveshja në mes të komunës së Çelanos dhe komunës së Hanit të Elezit do të nënshkruhet në mes dy kryetarëve dhe ajo marrëveshje i saktëson fushat se ku ka me pasur bashkëpunim dhe e njëjta marrëveshje përsëri do të miratohet në kuvendin e komunës dhe dërgohet në MAPL. Tash është nisma si hap i parë e cila i jep të drejtë kryetarit të komunës dhe përgjegjësi me i vazhduar bisedimet për fushat e përcaktuara, merret vendimi dërgohet për Ministri dhe pastaj përcillet te komuna e Çelanos. Fushat të cilat do të specifikohen është mirë edhe në kuvendin e komunës që me ndihmuar kryetarin e komunës me propozime të ndryshme në mënyrë që marrëveshja të jetë sa më e favorshme.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

**U VOTUA NISMA PËR BASHKËPUNIM NDËR KOMUNAL NDËRMJET KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT DHE KOMUNËS SË ÇELANOS (ITALI) QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

### **3. Shqyrtimi i planit komunal të veprimit për eficiency e energjisë për vitin 2019-2021.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- është një plan i përgjithshëm për kursim të energjisë dhe komuna e Hanit të Elezit do të jetë pjesë e kursimit. Ne po insistojmë që me anë të këtij projekti të përfitojmë një grand me të cilin do të kishim ndërruar ndriçimin publik me një ndriçim që do të kursejmë energji elektrike. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

**U VOTUA PLANI KOMUNAL I VEPRIMIT PËR EFIÇIENCËN E ENERGISË PËR VITIN 2019-2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

### **4. Shqyrtimi i raportit të punës së komitetit për komunitete për vitin 2018.**

**Kryesuesi** thekson:- është një gabim teknik dhe duhet të ndryshohet për mbledhje të kuvendit sepse shënon viti 2017 kurse duhet të jetë 2018. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

**U VOTUA RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2018 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

## 5. Shqyrtimi i raportit të punës së tri komiteteve konsultative për vitin 2018.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

**U VOTUA RAPORTI I PUNËS SË TRI KOMITETEVE KONSULTATIVE PËR VITIN 2018 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

## 6. Njoftim për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2018.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- takimet mbahen të rregullta për çdo muaj dhe nuk ka pasur ndonjë aktivitet që e ka përshkruar vitin 2018 që ka qenë shqetësues. Janë diskutuar çështje të rëndësishme për komunitetin. Diskutimet janë zhvilluar rreth shkollave , rreth dukurive negative. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- ne dimë që janë zënë disa lëndë narkotike dhe janë arrestuar katër apo pesë persona të Hanit të Elezit. Është dyshuar që ka përdorim të lëndëve narkotike nëpër shkolla dhe unë jam mësimdhënës dhe nuk e shohë që ka, mirëpo si shqetësim është për deri sa bartet droga nëpër kufij. Nëse barten 250 kg ndoshta 2 kg mund të mbesin këndeje pari. Këshilli për Siguri në Bashkësi a e ka pas parasysh këtë çështje dhe a e ka shqyrtuar dhe a ka ardhur deri te ndonjë definicion se a ndalet këtu apo nuk ndalet për shkak se një herë është nxënë dhe nuk dihet sa herë të tjera nuk është nxënë. Qytetarët potencojnë se nëpër kafiteri përdoren substanca narkotike por nuk e kanë argumentuar me fotografi apo me ndonjë ngjizim. Këshilli komunal është mirë me i pas parasysh këto çështje.

**Mallzum Qajani** thekson:- të njëjtat çështje hapen për diskutim në Këshillin Komunal për Siguri në bashkësi dhe këto informata që i kërkojmë ne, nuk besoj që ektzaktësisht nuk i ka as stacioni policorë në Han të Elezit. Është diskutuar që përdoret nëpër shkolla dhe deri në janar të viti 2018 kam qenë mësimdhënës në shkollën e mesme “Dardania” dhe nuk them që nuk ka individ të shkollës së mesme që se përdorin por në objektin e shkollës së mesme dhe në oborin e shkollës së mesme deri sa kam qenë mësimdhënës aty nuk ka pasur përdorim të substancave narkotike së paku për informatat që unë kam pasur. Unë nuk po them që në Han të Elezit nuk përdoret droga për arsye se përdoret në tërë Kosovën. Janë organet e specializuara që i hulumtojnë dhe nuk vijnë me na dhënë informacion në komitet për siguri dhe këto informacione nuk i ka komuna.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- nuk ke qëllimi se a përdoret në shkollë por Këshilli Komunal për Siguri ka të bëjë për tërë komunën sepse nuk mund të jenë nxënës të shkollave por mund të jenë qytetarë të tjerë dhe me u munduar së paku me i identifikuar dhe duhet të bëhen hulumtime dhe angazhime për me i ndaluar dukuritë negative. Është shënuar trajtimi i qenve endacak dhe nuk është bërë asgjë dhe nëse ndodhë ndonjë rast sikur ka ndodhë në komunat tjera krejt do të shqetësohemi. Është mirë para se me ndodhë me marr masa.

**Akif Shkreta** thekson:- po e ngrisim një çështje për të cilën ndoshta nuk kemi të drejtë dhe mundet ta diskutojmë dhe e kryem detyrën e vetë si organ , mirëpo duhet të dallohen kompetencat sepse është çështje policisë që të merret me këtë çështje. Unë rri shumë në Han të Elezit por ishalla nuk konsumohen lëndët narkotike se sa paragjykohet që përdoren lëndët narkotike. Është paragjykim i qytetarëve sepse nuk kemi dëshmi apo ndonjë raport. Raport ka që është transportuar droga dhe nuk kemi raport që është ndalur këtu droga.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- problemi nuk është që a përdoren substancat narkotike në shkollë apo në oborr të shkollës por përgjegjësitë tona janë për në Han të Elezit deri sa ka dyshime në Han të Elezit për dyshime për kontrabandim të substancave narkotike që është shqetësuese dhe duhet të merren angazhime për masat parandaluese.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

**U VOTUA NJOFTIMI PËR AKTIVITET E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2018 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**7. Njoftim për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2018.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Edon Curri** thekson:- materialin e keni pranuar me kohë por vetëm raporti i këshillit të fshatit Paldenicë më ka ardhur me vonesë, nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:-është shqetësuese se disa kryetarë të këshillave të fshatrave nuk kanë paraqitur raport dhe neni gjashtë i Rregullores për këshillat e fshatrave i parashih procedurat për shkak se kanë përgjegjësi dhe duhet të paraqesin raport.

**Edon Curri** thekson:-me kryetarët e këshillave kam kontaktuar për çështje të raportit por nuk kanë përcjell raport.

**Akif Shkreta** thekson:- më mirë do të ishte që kryetarët e këshillave të fshatrave që për mbledhje kuvendit me i paraqitur vetëm aktivitetet.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- si drejtor për këtë çështje duhet të veproni në bazë të rregullave dhe ligjeve dhe ndoshta nuk mundet me i pëlqyer dikujt por megjithatë janë rregulloret.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

**U VOTUA NJOFTIMI PËR AKTIVITETE E KËSHILLAVE TË FSHATRAVE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2018 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**8. Të ndryshme.**

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në ora 11:56 ju faleminderit për pjesëmarrje.

**Procesmbajtësi**

**Avni Bushi**

